Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e ofertes ;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- e. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;
- f. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;
- g. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;
- h. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
- i. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” të kësaj shtojce (Shtojca 12).

i. 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- Vertetim të xhiros mesatare të realizuar gjatë viteve 2017 ,2018 dhe 2019 lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit. (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).
- ii. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2017, 2018,2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuara nga ky autoritet, të shoqëruara me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar. (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).
- iii. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitet 2018, 2019 dhe kesteve te maturuara te vitit 2020, te lëshuar prej sejciles prej njërive të vetqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, sipas përcaktimeve e afateve në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të remë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma ”a”, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

2.3.1. 2.3 Per kapacitetin teknik: Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm , në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Ose

- b. Punë të ngjashme , deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të mësipërme e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik, do të kryhet duke u bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. *Për kontrata të realizuara me sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*
1. Formularin e vleresimit
 2. Kontratën/Kontratrat
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marjes ne dorezim.
 6. Faturat tatimore
- ii. *Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*
1. Formularin e vleresimit
 2. Kontrate;
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Akt kolaudimi objekti;
 5. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.
 7. Çertifikaten e marjes ne dorezim.

Në rastin kur oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë krahas dokumentacionit të mësipërm: edhe kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë krahas dokumentacionit të mësipërm: edhe kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

- 2.3.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar me kohë të plotë minimalisht 65 (gjashtedhjetë e pese) punonjës për periudhën maj 2020 – tetor 2020, të vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj të periudhës së mësipërme.
- b. Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj të periudhës së mësipërme.

Ndër punonjësve të mësipërm duhet të ketë:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt.
Stafi i drejtuesve teknik të shoqërisë, duhet të jetë i punësuar për **së paku tre muajt e fundit** dhe duhet të përbëhet nga inxhinierët e mëposhtëm:
 - 1 (nje) inxhinier ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë;
 - 1 (nje) inxhinier gjeodet/topograf/markshejder, shoqëruar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë;
 - 1 (një) inxhinier elektrik, shoqëruar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 3 (tre) punonjës të pajisur me **çertifikatë për dhënien e ndihmës së parë**, të siguruar sipas listëpagesës **së paku për muajin e fundit** dhe shoqëruar me kontratë pune dhe çertifikatën përkatëse, lëshuar nga organe kompetente publike ose private.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar **1 (një) mjek të përgjithshëm**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense per ushtrimin individual te profesionit, diplomë.(Në mbështetje të VKM Nr. 632 date 15.07.2015”Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr.108 date 09.02.2011,te Keshillit te Ministrave “Per aftesite qe duhet te plotesojne punemarresit,personat dhe sherbimet e specializuara,qe merren me ceshtjet e sigurise dhe shendetit ne pune” në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, **apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë**, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik/punonjës/ specialistë të pajisur me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose çertifikata ekuivalente të cilat të jenë të lëshuara nga organe/shoqëri të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe me dëshmi të aftësimit profesional/çertifikatë/diplomë, të siguruar sipas **listë pagesës së muajin te fundit**, si më poshtë:
 - 2 (dy) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës),
 - 2 (dy) hidraulik, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues;
 - 2 (dy) elektrikist, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues

- 2 (dy) kartpentiere, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues;
 - 2 (dy) pllakashtrues, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues
 - 1 (një) betonues, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues
 - 5 (pese) manovratorë mjetesh të rënda (buldozerit/ eksvatorist /automakinist), shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), lejen e drejtimit (patenten);
 - 5 (pese) shoferë, shoqëruar me kontratë individuale pune, leje drejtimi dhe CAP;
5. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë ;

a.1 (një) punonjës, që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve ,i pajisur me çertifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

b. 1 (një) punonjës _ Çertifikuar si Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis, ne përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit

c. 1 (një) Inxhinier _ Çertifikuar per Sigurimin dhe kontrollin e cilesise ISO 9001:2015

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë/certifikate
- Deklaratë nga administratori
- Te jene ne liste pagesat e shoqerise se paku ne muajin e fundit

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës dhe deri në propozimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për marrje masash ndaj operatorëve ekonomikë.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim drejtuesin/esit teknik te punimeve, në rast se shpallet fitues për këtë procedure

2.3.4. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, sipas formatit të

Dokumenta Standarde të Tenderit

miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara si më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punimeve të objektit duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

N.P – 1 A Punime gjurmimi në tokë.

N.P – 4 B Rrugë, autostrada, mbikalime hekurudha, metro, pista aeroportuale

NP 11 A Ndertime per nestacione elektrike , linja TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:

N.S – 6 A Sinjalistike rrugore jo ndricuese

N.S – 18 A Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës të autorizuar, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2.3.5. A.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportime mbetjeve, jo te rrezikshme).

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise,ose **standardeve shqiptare SSH** mbi komformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent
- ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalent
- OHSAS 18001:2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent ISO 45001:2018

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (shtojca 10), si më poshtë:

Nr	Lloji i Mjeteve/Makinerive	Statusi	Sasia
----	----------------------------	---------	-------

Dokumenta Standarde të Tenderit

1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
3	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
5	Mjete gjërmimi me goma / fadroma	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	cope 1
7	Asfalto shtruese	në pronësi ose me qira	Cope 1
8	Buldozer	në pronësi ose me qira	Cope 1
9	Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Cope 1
10	Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Sharrë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Autovinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Pompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Minifadromë	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Rrul ngjeshës	në pronësi ose me qira	Copë 2
19	Cekic pneumatik	në pronësi ose me qira	Copë 2
20	Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	në pronësi / me qira	Copë 1
21	Linjë prodhimi inertesh, e pajisur me leje mjedisore	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1
22	Vibrues pllakash	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Fabrikë asfaltobetonit e pajisur me leje mjedisore, me distancë jo më shumë se 60 km nga objekti që prokurohet në zbatim të VKM nr 628 datë 15.07.2015, ose Fabrike mobile të levizshme	në pronësi / me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1
24	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Betoniere (Perzjerese betoni)	në pronësi ose me qira	Copë 3

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore - minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila - minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi - minimumi 4 copë
- Kullë ndriçimi - minimumi 1 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë - minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt - minimumi 30 copë
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe/ose faturat tatimore, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerasë, faturat tatimore dhe/ose kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.
- Për mjetet vetëlëvizëse që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: -çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracionin);leja e transportit dhe fotot përkatëse; Ndërsa për mjete të marra me qera, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerasë.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Për mjetet vetëlëvizëse që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerasë.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera që operatori ekonomik ka aktualisht në proces zbatimi. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a", të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t`i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të respektojnë rigorozisht udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik për operatorët ekonomikë për rastin e bashkimit të operatorëve në procedurat elektronike të prokurimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: bashkëngjitur

Specifikimet Teknike të Materialeve: bashkëngjitur

Grafiku i Punimeve: 60 dite

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[*Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS **Punët – Procedura e Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore

ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

